Eshtë pranë me Megatek 52 vite

HOROSKOPI

Kronikë

Sarandë/ Pronari i 'Pemës së Thatë' vritet me plumb në kokë, i doli në mbrojtje mikut të tij! Në kërkim autori e 4 të tjerë, në polici i plagosuri (EMRAT)

5 persona janë shpallur në kërkim dhe një tjetër është shoqëruar nga policia për vrasjen e biznesmenit Rexhep Ismaili në Sarandë. Konflikti dyshohet të ketë nisur për çështje pronash mes Viktor Ruçit dhe një personi tjetër, ndërsa përplasja fizike në lokal përfundoi me vrasjen e 66-vjeçarit nga Lulzim Tabaku, i cili është ende në arrati.

■ Report Tv siguron foton e mikut të Rexhep Ismailit, në konflikt me autorët për çështje pronash

■ Ina Zhupa: PD humbi një bashkëpunëtor të vyer

■ Vrasja e pronarit të karburantit, Bido: I kobshëm lajmi i vrasjes i drejtuesit të Shoqatës 'Çamëria' në Sarandë

Redaksia
8 Maj, 08:08 | **Përditesimi: 8 Maj, 18:43**

Share Post

SARANDË- 5 persona janë shpallur në kërkim ndërsa 1 tjetër është shoqëruar në polici, të dyshuar si të përfshirë në vrasjen e biznesmenit Rexhep Ismaili 66 vjeç, ngjarje e ndodhur mbrëmjen e djeshme në lokalin në pronësi të tij në fshatin Gjashtë në dalje të Sarandës. Autor i vrasjes është Lulzim Tabaku, i cili vijon të jetë në arrati së bashku me Idriz Çela, Eljo Muço, Marjo Agalliu dhe Ermal Shkalla, të cilët akuzohen për kanosje e shkatërrim të pronës.

Shkak është bërë një konflikt që miku i 66-vjeçarit, Viktor Ruçi, i cili ndodhej në lokal, kishte me një tjetër person për çështje pronash në zonën e bregdetit. Teksa Ruçi ishte në tavolinë me Rexhep Ismailin dhe me disa persona të tjerë, 6 vetë kanë mbërritur në lokal ku menjëherë ka nisur një përplasje e ashpër fizike që ka përfunduar në shkrehjen e armëve dhe vrasjen e 66-vjeçarit me 1 plumb në kokë.

Në policia është shoqëruar 31-vjeçari Kostandin Vogli, i dyshuar si personi që ishte në konflikt me Ruçin. Ai është dërguar në spital për ndihmë mjekësore pasi ka mbetur i plagosur në këmbë.

Dinamika e ngjarjes

Rreth orës 21:30, në lokalin e Rexhep Ismailit, mbërriti një grup prej 6 personash, pasi i kishte thirrur Kostandin Vogli, i cili kishte informacion se te karburanti dhe lokali i vëllezërve Ismaili ndodhej 50-vjeçari Viktor Ruçi, me origjinë nga Tepelena dhe banues në fshatin Gjashtë.

Në sherr e sipër, 66-vjeçari Rexhep Ismaili është futur brenda lokalit dhe ka dalë me "Kallashnikov", duke hapur zjarr disa herë ku ka mbetur i plagosur Kostandin Vogli. Ndërsa autori i dyshuar, Lulzim Tabaku, e ka qëlluar me pistoletë me plumb në kokë Ismailin. Pas ngjarjes, autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i krimit.

Vëllai i Rexhep Ismailit ka fshehur armën automatike me të cilin 66-vjeçari qëlloi në drejtim të grupit me 6 persona, tashmë e gjetur dhe e sekuestruar nga policia së bashku me një krehër me 21 fishekë. Ndërkohë është sekuestruar një automjet tip 'Audi Q8' i dyshuar si i përdorur nga të dyshuarit dhe fishekë dhe gëzhoja të kalibrave të ndryshëm. Sakaq, në fshatin Nivicë është gjetur i braktisur motomjeti me të cilin dyshohet se është larguar nga vendi i ngjarjes autori Lulzim Tabaku.

Rexhep Ismaili është gjithashtu pronar i një prej plazheve më të njohura private, 'Perna e Thatë' në Ksamil si dhe eksponent i PD. Vrasja e tij ka shkaktuar reagime të forta në politikë. Deputeti i PS-së Ardit Bido e ka cilësuar ngjarjen "të kobshme", duke theksuar se Ismaili drejtonte shoqatën "Çamëria" në Sarandë dhe ishte një zë i fortë në mbrojtje të kauzës shqiptare. Edhe deputetja e PD-së Ina Zhupa është shprehur e tronditur, duke theksuar se demokratët humbën një figurë të rëndësishme, pjesë e strukturave të PD-së.

Një prej mjeteve të autorëve që mbeti në vendngjarje

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:48

Vrasja në Sarandë/ Miku i biznesmenit në konflikt me 6 persona, shpallen në kërkim! Gjendet në Nivicë motori me të cilin u largua autori

Drejtori i Policisë së Vlorës Elidon Çela ka dalë sot me një deklaratë publike ku ka informuar për zbardhjen e vrasjes së biznesmenit Rexhep Ismaili në lokalin në pronësi të tij në fshatin Gjashtë në Sarandë.

Deklarata e plotë e drejtorit të policisë Vlorë

Jam sot këtu për të informuar opinionin publik lidhur me veprimet e shpejta, intensive dhe profesionale hetimore, të kryera nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve ndaj Personit dhe Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Sarandë, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me qëllim zbardhjen e autorësisë dhe rrethanave të ngjarjes së ndodhur rreth orës 21:30 të datës 07.05.2026.

Ngjarja ka ndodhur në kryqëzimin e fshatit Gjashtë, në ambientet e lokalit në pronësi të shtetasit R. I., (Rexhep Ismaili) ku mbeti i vrarë me armë zjarri shtetasi R. I., 66 vjeç, si dhe u plagos shtetasi K.V. (Kostandin Vogli).

Si rezultat i veprimeve hetimore, u bë i mundur identifikimi i autorit të dyshuar të vrasjes si dhe zbardhja e dinamikës së ngjarjes.

Gjithashtu, vetëm pak momente më parë është bërë dhe shoqërimi i shtetasit të plagosur Kostandin Vogli i cili aktualisht po merr ndihmën mjekësore dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Në vijim ky shtetas do t'u nënshtrohet procedurave penale.

Nga hetimet rezultoi se mbrëmjen e djeshme, shtetasit:

L.T., Lulzim Tabaku

I.C., Idriz Çela

E.M., Eljo Muço

K.V., Kostandin Vogli

M.A Marjo Agalliu

dhe E.Sh.Ermal Shkalla

kanë shkuar në lokalin e viktimës dhe janë drejtuar te tavolina ku ndodheshin shtetasi Viktor Ruçi i shoqëruar nga viktima dhe persona të tjerë të pranishëm duke filluar menjëherë konflikton me sende të forta me këta shtetas.

Gjatë konfliktit të dhunshëm, rezulton se viktima R. I ka marrë një armë zjarri automatike dhe ka qëlluar në drejtim të shtetasve të përfshirë në konflikt,

Në vijim të ngjarjes, dyshohet se shtetasi L. T. ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në drejtim të shtetasit R. I., i cili për pasojë ka humbur jetën në vendngjarje.

Gjithashtu gjatë shkëmbit të zjarrit ka mbetur i plagosur në këmbë edhe shtetasi K.V.

Pas ngjarjes, të gjithë shtetasit e përfshirë në konflikt janë larguar nga vendi i ngjarjes. Ndërkohë, dyshohet se vëllai i viktimës, shtetasi H. I., ka larguar nga vendngjarja dhe fshehur armën e zjarrit automatike së bashku me një krehër me 21 fishekë, të cilat më pas u gjetën dhe u sekuestruan nga Policia, në cilësinë e provës materiale.

Gjithashtu, u sekuestruan prova të tjera materiale, konkretisht një automjet tip "Audi Q8", dhe fishekë dhe gëzhoja të kalibrave të ndryshëm dhe sende të tjera që do t'i shërbejnë vijimit të hetimeve.

Gjatë kontrolleve të mëtejshme, në fshatin Nivicë u gjet i braktisur motomjeti, me të cilin dyshohet se është larguar nga vendngjarja autori i dyshuar, shtetasi L. T. Po ashtu, në lagjen nr. 1, Sarandë, u gjet dhe u bllokua një automjet tip "Audi", i cili dyshohet se është përdorur nga autorët e përfshirë në ngjarje.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore, u shpallën në kërkim shtetasit:

L. T., 37 vjeç, për veprat penale "Vrasja me dashje" dhe "Armëmbajtja pa leje";

I. C., 40 vjeç, E. M., 19 vjeç, K. V., 31 vjeç, M. A., 22 vjeç dhe E. Sh., 21 vjeç, për veprat penale "Kanosja" dhe "Shkatërrimi i pronës".

Si dhe u proceduar penalisht shtetasi H. I. (Hajredin Ismaili) 60 vjeç, vëllai i viktimës.

Vijojnë hetimet intensive për zbardhjen e plotë të dinamikës së ngjarjes si dhe kërkimet intensive për lokalizimin dhe kapjen e të gjithë shtetasve të shpallur në kërkim.

Në këtë kuadër, ftojmë qytetarët të bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, duke dhënë çdo informacion të vlefshëm për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim dhe për parandalimin e veprimeve të palejëshme.